

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTE

Në Tiranë, sot me datë 17.11.2022, palët nënshkruese si më poshtë bien dakort për të lidhur këtë kontratë për shitblerje kuotash të kapitalit të shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k.

Shitësi:

Z. Fikret BANGU, i biri i Orhan, lindur në Vushtrri, Kosovë, më 23.02.1973, banues në Rr. "Marin Barleti nr.45", Vushtrri, Kosovë, identifikuar me kartën e identitetit nr. ID1087706 me nr.personal 1001761109, shtetas kosovar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Blerësi:

Z. Hekuran BRAHIMAJ, i biri i Rystem, lindur në Katundisht, Përmet, më 13.08.1972 dhe banues në Rr. "Kodra e Bukur 15", Vorë, shtetas shqiptar, identifikuar me kartën e identitetit nr.031162491, me Nr. Personal H20813103N, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Neni 1

- 1.1 Shitësi **Fikret BANGU** është ortak i shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS M11906023S. Nga kuotat e kapitalit të shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k. shitësi zotëron 1 kuotë në vlerën 33% të kapitalit të nënshkruar. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 300.000 Lekë.
- 1.2 ..Shitësi në bazë të vendimit datë 17.11.2022 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k., i shit tërësisht kuotën e zotëruar prej tij në nivelin 33% të kapitalit të nënshkruar të shoqëriës Blerësit, i cili pranon t'i blejë ato, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 2

- 2.1 Çmimi i shitjes së 1 kuote që përfaqëson 33% të kapitalit të shoqërisë shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k. është 50.000 Lekë.
- 2.2 Çmimi prej 50.000 Lekësh konsiderohet i likujdua cash plotësisht me nënshkrimin e kontratës nga të dyja palët.

Neni 3

- 3.1 Me shitjen e kësaj kuote, sipas kësaj kontrate, shitësi humbet pronësinë mbi këtë kuotë dhe blerësi bëhet pronar i këtyre kuotave me të drejta të plota.



Neni 4

4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotën që i transferon blerësit e cila është e lirë nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë, nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj apo t'u ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi deri në datën e sotme që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së blerësit mbi to.

Neni 5

5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.

5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5.3 Dokumentet bashkëlidhur kësaj kontrate do të jenë Vendimi i datës 17.11.2022 i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë ALRES Energy 1 sh.p.k. dhe është pjesë integrale e kësaj kontrate.

Kjo kontratë hartohet në 4 kopje me të njëjtën vlerë ligjore dhe palët pasi e lexuan dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë e nënshkruajnë.

PALËT KONTRAKTORE

Shitësi

Fikret BANGU



Blerësi

Hekuran BRAHIMAJ